Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që Komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Entit Rregullator të Energjisë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### 3. PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

#### 3. Pranimi në shërbimin civil

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, dhe ngritjes në detyrë, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.*

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon

1. Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” ose ekuivalentenë fushën e Inxhinjerisë Elektrike.
2. Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe preferohet 3 vite pune në fushën Energjitike.
3. Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjistikës.
4. Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
5. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
6. Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

### **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

1. Kerkese për pozicionin e aplikuar.
2. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
3. <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
4. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
11. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 09.02.2022, në Entin Rregullator të Energjisë.***

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

### 3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 11.02.2022, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ngarkuar e institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### 3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar.
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dale në zbatim të tij;
4. Ligjin Nr. 8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
6. 6. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
8. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
9. “Rregullat për monitorimin e tregut të gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 265, datë 28.12.2020.
10. “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror.” miratuar me vendimin e ERE-s nr. 97, date 04.07.2017
11. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
12. . Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

### **3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

### **3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Enti Rregullator I Energjisë do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

**NJËSIA PËRGJEGJËSE E NGARKUAR.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE**

**NGRITJE NË DETYRË**

**PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

**NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreu-II “Lëvizja paralele të nivelit të mesëm drejtues brënda të njëjtës kategori“ ; Kreu III “Ngritja në detyrë të nivelit të ulët drejtues në nivelin e mesëm drejtues të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015,“ Për plotësimin e vëndeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” si dhe planit vjetor të pranim 2021 në shërbimincivil tëEnti Rregullator të Energjisë“, Njësia Përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, shpall procedurën e lëvizjes paralele, të ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

**PËRGJEGJËS SEKTORI I BURIME NJEREZORE DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE**

Kategoria e pagës III-a.

*Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit Civil. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, rezulton se një pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranim nga jashtë shërbimit civil.*

**Për tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë.**

Numri i pozicioneve për të cilat do të konkurohet është 1 (një).

**Afati për dorëzimin e dokumenteve :**

**16.11.2021 deri në datën 25.11.2021**  
**21.12.2021 deri në datën 30.12.2021**  
**26.01.2022 deri në datën 09.02.2022**

**Lëvizja paralele**  
**Ngritje në detyrë**  
**Pranim nga jashtë shërbimit civil**



## **Misioni i Përgjegjës të Sektorit:**

Ne mbështetur te ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin Civil*”, i ndryshuar si dhe Kodin e Punes, ndjek administrimi i shërbimit civil ne institucion .

## **Qëllimi i pozicionit të punës:**

Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, dhe personaleit të ERE-s , ne zbatimin te permbushjes se detyrimeve qe burojne nga ligji Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin Civil*”, i ndryshuar, Kodi i Punes si dhe zbatimin dhe respektimin e Kodit te Etikes.

## **Përshkrimi përgjithësues i punës**

1. Përgjigjet për zbatimin e pozicionimit të personelit sipas strukturës së miratuar .
2. Koordinon dhe mbikëqyr punën e punonjësve nën varësi.
3. Kontrollon dhe shpërndan sipas destinacionit dokumentat e hartuara dhe korendimentet nga punonjësit nën varësi.
4. Siguron bashkëpunim të mirë të grupit dhe ekzekutimin në kohë të detyrave.
5. Vlerëson performancën e punonjësve nën varësi në përputhje me procedurat e legjislativës në fuqi.
6. Për emërimet e reja të personelit, ndjek zbatimin e kritereve të përcaktuara në ligj.
7. Koordinon procesin e rekrutimit të stafit nëpërmjet evidencës të nevojave të institucionit për burimet njerëzore dhe merr masat për rekrutimin e stafit nëpërmjet nevojave të institucionit sipas legjislativës në fuqi.
8. Për emërimet e reja të personelit, ndjek zbatimin e kritereve të përcaktuara në ligj.
9. Bashkëpunon me strukturat brenda institucionit, për alokimin dhe propozimin për ndryshimet në strukturën e organizimit të ERE.
10. Ndjek në vazhdimësi sigurimin e kushteve normale të punës në zyrat e institucionit.
11. Raporton periodikisht tek Sekretari i Përgjithshëm mbi lëvizjen e punonjësve sipas urdhrave të brendshëm, të firmosur nga Kryetari, detyrave të ngarkura apo të mungesave me arsye të cilat i njoftohen edhe Drejtorisë së Financave dhe IT.
12. Drejton procesin e planifikimit, në bashkëpunim me drejtuesit e strukturave, për lejet e zakonshme për personelin dhe plotëson me shkrim dokumentacionin për dhënien e lejes së miratuar nga titullari i institucionit.
13. Asiston dhe bashkëpunon me strukturat, për realizimin e vlerësimeve individuale, përgatitjen e praktikave për konfirmimin ose jo të punonjësve, procedurave disiplinore, përshkrimin e punës për vendet vakante sipas legjislativës në fuqi dhe shpalljen e tyre brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj si dhe kryerjen e procedurave të tjera dhe hartimin e akteve shkresore përkatëse,
14. Monitoron respektimin e orareve të punës ,disiplinës dhe etikës nga punonjësit të cilat ja njofton Sekretarit të Përgjithshëm dhe propozon marrjen e masave disiplinore sipas rastit.
15. Drejton funksionet menaxhuese të burimeve njerëzore për institucionin, përfshirë rekrutimin e ndarjen e detyrave në personelin e vartësit ,trajtimin dhe zhvillimin, vlerësimet e performancës asistencë ndaj punonjësve.
16. Harton praktikatat e pranimit, propozimit, dhe largimit të personelit të ERE-s.
17. Zbaton, interpreton dhe monitoron zbatimin në përputhje me Kodin e Punës të procedurave të brendshme të Burimeve Njerëzore.

18. Siguron përpuethshmerinë me Ligjet në fuqi të aplikuara, rregulloret dhe /ose rregullat e ERE, standartet dhe udhëzimet.

19. Bashkëpunon me stafin për tu imlementuar sa më shumë vlerat e institucionit, për të rritur frymën e punës së grupit, komunikimit dhe për realizimin e objektivave.

20. Udhëheq procesin për rishikimin e përshkrimeve të punës, monitorimin e detyrave dhe ngarkesës së punonjësve, dhe në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm bëjnë propozimet përkatëse në Bord.

21. Përgatit të dhënat për vjetërsinë në punë të punonjësve për pagesën e tyre konform rregullave dhe ia bën me dije Drejtorit të DEF.

22. Përgatit informacionin për Kryetarin mbi nevojën e caktimit të autoritetit përgjegjës për mardhëniën e institucionit me ILDKPI.

23. Harton politikat e burimeve njërezore për mbulimin e nevojave të institucionit për staf të ri apo specialistë mbështetës në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm .

24. Ruan integritetin e tij profesional në formë dhe në përmbajtje.

## **1-LEVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori , në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LEVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë për levizjen paralele si vijon :**

**-të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon  
kategoria III-a/1**

**- të mos ketë masa disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);**

**-të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”**

### **KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- 1. Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën Juridike/Ekonomike/ Shkenca Sociale.**
- 2. Të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune dhe preferohet 2 vite pune ne menaxhimin e burimeve njerezore.**
- 3. Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombetar në fushën e energjitikës.**
- 4. Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma), apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.**
- 5. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;**
- 6. Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe të shquhet për përgatitje të lartë profesionale;**

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur; Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të diplomës të arsimimit e noterizuar;
- Vërtetime të institucioneve që dëshmojnë eksperiencë pune në nivelin e menaxhimit / librezë pune.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, në nivel kombëtar e në nivelin menaxherial apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aktin e emërimit si nënpunës civil, nese ka per nivelin përkatës te konkurimit.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo pranë zyrës së Protokollit në institucion, brenda datës 25.11.2021 (10 ditë kalendarike nga data e shpalljes)2021.*

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës **26.11.2021**, njësia përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën , vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët të paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (ditë ) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e përgjegjëse e ngarkuar pranë ERE-s do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

#### **A. Njohuritë mbi :**

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar;
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshur.
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996; Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003; Ndryshuar me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008; Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.20151) (I përditësuar)
5. Ligjin Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
6. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
8. Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “ Për arkivat”
9. Ligjin Nr. 119/2014,“Për të drejtën e informimit”;
10. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
11. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
12. Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”
13. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

#### **B. Aftësitë për të:**

- Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qënë të parashikuara, deri ne nivelin e hierarkise përkatëse;
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme;
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre;
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme;
- Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave;
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore.

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar :**

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur në ERE ,nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës të strukturuar me gojë .Totali I pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë , të cilat ndahen përkatësisht:

- Vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve në fushën përkatëse, si dhe vlerësimet e menaxhimit të nivelit të lartë drejtues në organizma rajonale ndërkombëtare -40 pikë.
- Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :
- Njohuritë, aftësitë ,kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme
- Motivimin ,aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Komisioni në përfundim të vlerësimit njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ERE do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e i Punësimit dhe Aftësive” dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

1.7

## DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse ERE do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e i Punësimit dhe Aftësiv”si dhe në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## 2- NGRITJE NË DETYRË / PRANIM NGA SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga jashte shërbimit civil.

**Këtë informacion do ta merrni në faqen e ERE-s, pas datës 20.12.2021.**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire dhe/ose kandidate të tjerë nga shërbimi civil..*

## **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE/OSE NGA SHËRBIMI CIVIL KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III- a/1 ;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

### **a. Arsimimi:**

1. Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën Juridike/Ekonomike/ Shkenca Sociale..
2. Të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune dhe preferohet 2 vite pune ne menaxhimin e burimeve njerezore.
3. Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombetar në fushën e energjitikës. Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një çertifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
5. Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

### **b. Tjetër:**

- Të zotërojë aftësi të dallueshme komunikimi .
- Të ketë aftësi organizimi dhe menaxhimi .

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

1. Kërkesë për pozicionin e aplikuar.

1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.

2) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

- 3) Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) Aktin e emërimit si nëpunës civil (për aplikantët për ngritje në detyrë)

**Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda dates 30.12.2021, në Entin Rregullator të Energjisë,**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë nga shërbimi civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Ere-s, sipas afateve të përcaktuara për zhvillimin e kësaj procedure.

Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e ERE-s, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” si dhe në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia Njësia përgjegjëse e Ngarkuar, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brënda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

## 2.2

### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar;2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshur.
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996; Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003; Ndryshuar me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008; Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.20151) (I përditësuar)
5. Ligjin Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
6. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;8. Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “ Për arkivat”
9. Ligjin Nr. 119/2014,“Për të drejtën e informimit”;
10. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
11. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
12. Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”
13. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

## **2.3 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti I Përhershëm Pranimit në ERE, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**



a-intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 60 gjashtedhjetë pike.

b.- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 dyzete pike.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në VKM nr. 242, date 18.03.2015.

## 2.4

### DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ” si dhe në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që Komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përherëshëm të Pranimi për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Entit Rregullator të Energjisë , do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

## 3. PRANIM NGA JASHTE SHËRBIMIT CIVIL

### 3. Pranimi në shërbimin civil

---

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, dhe ngritjes në detyrë, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.*

### **3.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon

1. Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën Juridike/Ekonomike/ Shkenca Sociale.
2. Të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune dhe preferohet 2 vite pune në menaxhimin e burimeve njerezore..
3. Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjitikës.
4. Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
5. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
6. Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

### **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

1. Kerkese për pozicionin e aplikuar.

2. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
3. <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
4. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
11. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 09.02.2022, në Entin Rregullator të Energjisë.***

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

### **3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 11.02.2022, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vëndin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ngarkuar e institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar;
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshur.
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996; Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003; Ndryshuar me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008; Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.20151) (I përditësuar)
5. Ligjin Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
6. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
8. Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “ Për arkivat”
9. Ligjin Nr. 119/2014,“Për të drejtën e informimit”;
10. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
11. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
12. Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”
13. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

### 3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

---

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

### 3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Enti Rregullator I Energjisë do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

## **NJËSIA PËRGJEGJËSE E NGARKUAR.**